



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO

**GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT**

Prishtinë, më 28 tetor 2013
Nr. ref.:RK487/13

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

Rastin Nr. KI74/13

Parashtrues

Shefqet Hasimi

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të
Kosovës, Mlc. nr. 6/2012, të 16 prillit 2013**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar
Ivan Čukalović, Zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Kadri Kryeziu, gjyqtar dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtrues është z. Shefqet Hasimi, zyrtar ligjor në Ministrinë e Drejtësisë, me banim në Prishtinë. Parashtruesi ka parashtruar kërkesën në emër të tij.

Vendimet e kontestuara

2. Parashtruesi konteston Aktgjykimin e Gjykatës Supreme, Mlc. nr. 06/2012, të 16 prillit 2013, në lidhje me Aktgjykimin e Gjykatës Komunale në Prishtinë, C. nr. 682/09, të 21 dhjetorit 2011; Vendimin e Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, Ac. nr. 1276/2008, të 26 marsit 2009; dhe Aktgjykimin e Gjykatës Komunale në Prishtinë, Cl. nr. 238/07, të 19 dhjetorit 2007.

Baza juridike

3. Neni 113.7 i Kushtetutës, neni 20, 22.7 dhe 22.8 i Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121, i 15 janarit 2009 (në tekstin e mëtejme: Ligji); dhe rregulli 56.2 i Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Objekti i çështjes

4. Objekti i çështjes së kësaj kërkesë ka të bëjë me detyrimin e Komitetit Qendror Ndërmintor të Qeverisë së Kosovës (të përfaqësuar nga parashtruesi) si palë e paditur për të kompensuar mëditjet ndaj palës së tretë përkatësisht paditësit N. H. bazuar në kontratën dhe kryerjen e punës.
5. Paditësi N. H., në cilësinë e punonjësit, dhe Komiteti Qendror Ndërmintor i përfaqësuar nga parashtruesi, si palë e paditur në cilësinë e punëdhënësit, kishin pikëpamje të ndryshme përkitazi me kompensimin me mëditje të paditësit, që rezultoi në kontest juridik, me ç'rast gjykatat e rregullta vendosën në favor të paditësit. Më pas, parashtruesi (z. Shefqet Hasimi) parashtroi kërkesë në Gjykatë për të kontestuar vendimet e përmendura të gjykatave të rregullta.
6. Në kërkesë tregohet se parashtruesi ka qenë i autorizuar që të përfaqësojë Komitetin Qendror Ndërmintor të Qeverisë së Kosovës në procedurat para gjykatave të rregullta. Megjithatë, parashtruesi ka deklaruar shprehimisht se ai ka ngritur kërkesë individuale në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata), në emër të tij.

Procedura në Gjykatë

7. Më 17 maj 2013, parashtruesi dorëzoi kërkesën në Gjykatë.
8. Më 27 maj 2013, Kryetari caktoi gjyqtaren Snezhana Botusharova Gjyqtare raportuese dhe Kolegjin shqyrtues të përbërë nga gjyqtarët Robert Carolan (kryesues), Almiro Rodrigues dhe Enver Hasani.
9. Më 11 qershor 2013, Gjykata njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës. Të njëjtën datë, kërkesa iu komunikua Gjykatës Supreme të Kosovës.
10. Më 20 qershor 2013, Gjykata kërkoi nga parashtruesi të qartësojë nëse kërkesa ishte dorëzuar si kërkesë individuale në emër të tij.

11. Më 27 qershor 2013, parashtruesi i kërkesës dërgoi përgjigje.
12. Më 13 shtator 2013, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e Gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës në përbërje të plotë papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhje e fakteve siç dëshmohet nga dokumentet e dorëzuara nga parashtruesi

13. Më 19 dhjetor 2007, Gjykata Komunale në Prishtinë, me anë të Aktgjykimit Cl. nr. 238/07, miratoi padinë e paditësit N. H. dhe obligoi Qeverinë e Kosovës si palë e paditur, që të kompensojë paditësin për punën e kryer, në shumën prej 2,440 € për periudhën prej 1 majit 2005 deri më 15 nëntor 2005, në bazë të kontratës së punës për të cilën palët kishin rënë në ujdë më 8 shtator 2004.
14. Më 26 mars 2009, Gjykata e Qarkut në Prishtinë, me Vendimin Ac. nr. 1276/2008, prishi Aktgjykimin Cl. nr. 238/07 të Gjykatës Komunale në Prishtinë dhe ktheu rastin në rigjykim.
15. Më 21 dhjetor 2011, Gjykata Komunale në Prishtinë, me Aktgjykimin C. nr. 682/09, miratoi padinë e paditësit N. H. dhe obligoi Qeverinë e Kosovës - Komitetin Qendror Ndërmënistror që të kompensojë paditësin, për punën e bërë gjatë 122 ditëve të punës me një shumë të përgjithshme prej 2,440 €.
16. Më 16 prill 2013, Gjykata Supreme e Kosovës, me Aktgjykimin Mlc. nr. 6/2012, e refuzoi si të pabazuar kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë të parashtruar nga Prokurori i Shtetit i Kosovës kundër Aktgjykimit C. nr. 682/2009 të Gjykatës Komunale në Prishtinë, të 21 dhjetorit 2011.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

17. Parashtruesi pretendon se paditësi N. H. nuk ka punuar jashtë orarit të punës në përputhje me Ligjin për nëpunësit civilë, siç mund të dëshmohet nga regjistri i punës.
18. Parashtruesi më tej pretendon se të gjitha vendimet e parashtruara nga paditësi N. H. nuk janë miratuar dhe nënshkruar nga autoritetet përgjegjëse dhe të autorizuar dhe se paditësi N. H. ka kryer vetëm punë fiktive dhe si e tillë ishte miratuar nga gjykatat e rregullta.
19. Prandaj, parashtruesi konsideron se në rastin konkret ligji i zbatueshëm dhe Kushtetuta e Republikës së Kosovës ishin shkelur dhe i propozon Gjykatës që të rivlerësojë ligjshmërinë dhe kushtetutshmërinë e vendimeve përkatëse gjyqësore. Parashtruesi nuk specifikon shkeljen e pretenduar të ndonjë dispozite kushtetuese në veçanti.

Vlerësimi i pranueshmërisë

20. Gjkata Kushtetuese, për të qenë në gjendje të gjykojë për kërkesën e parashtruesit, duhet së pari të vlerësojë nëse parashtruesi i kërkesës i ka plotësuar kushtet e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe me Rregullore të punës.

21. Në këtë drejtim, Gjkata i referohet nenit 113.1 të Kushtetutës që parasheh:

“Gjkata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para Gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar”.

22. Gjkata gjithashtu i referohet Rregullit 36 (3) c) të Rregullores së punës që thekson:

“Po ashtu një kërkesë mund të konsiderohet si e papranueshme edhe në rastet vijuese kur:

[...]

c) kërkesa parashtrohet nga një palë e paautorizuar”...

23. Prandaj, Gjkata konsideron se së pari duhet të përcaktohet nëse parashtruesi është palë e autorizuar në kuptimin e dispozitave ligjore të lartpërmendura.

24. Në këtë rast, parashtruesi në lidhje me kërkesën inter alia ka theksuar:

“Meqenëse kjo kërkesë është regjistruar pranë Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës dhe ka marrë këtë numër, KI74/13, Ministria e Drejtësisë lidhur me dorëzimin e kërkesës, nuk i ka dhënë autorizim Shefqet Hasimit (parashtruesit)...

Gjkata Kushtetuese e Kosovës kërkesën e dorëzuar më 17 maj 2013, e që e ka marrë këtë numër të lëndës, KI74/2013, ta konsiderojë si kërkesë INDIVIDUALE nga Shefqet Hasimi (parashtruesi)...”.

25. Gjkata vëren se nga dokumentet e dorëzuara është e qartë se në procedurat para gjykatave të rregullta, parashtruesi ka përfaqësuar Komitetin Qendror Ndërmnishtor të Qeverisë së Kosovës, në cilësinë e palës së paditur. Pra, ai vetë nuk ishte palë në procedurë.

26. Gjkata, prandaj, konsideron se kërkesa nuk është parashtruar në mënyrë ligjore nga personi i autorizuar, siç kërkohet në bazë të nenit 113.1 të Kushtetutës.

27. Rrjedhimisht, kërkesa duhet të hidhet poshtë si e papranueshme në pajtim me nenin 113.1 të Kushtetutës dhe rregullin 36 (3) c) të Rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të nenit 113.1 të Kushtetutës, nenit 47 të Ligjit, dhe në pajtim me rregullin 36 (3) c) të Rregullores së punës, më 13 shtator 2013, njëzëri

VENDOSI

- I. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme;
- II. Ky vendim do t'u komunikohet palëve dhe do të publikohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit; dhe
- III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese

Snezhana Botusharova



Kryetari i Gjykatës Kushtetuese

Prof. dr. Enver Hasani